Elona SYLA
Notere

Taksa e paguar
Notere Elona A. Syla

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE TIRANË**
**Notere Elona A. SYLA**
***Nr.*** 707 ***Rep***
***Nr.*** 4377/3 ***Kol***

## *KONTRATË DHURIMI KUOTASH*

Sot, me date 28/03/2018(*dy mije e tetembëdhjete*), u paraqiten para meje noteres Elona A. Syla, anëtare e Dhomës së Noterisë, Tirane, me seli në Rr. "Shyqyri bërxolli", Pall. Aurora, kt.2, Tiranë, palet kontratuese me cilesite si me poshte:

**PALA DHURUESE: Z.Erik HYSENAJ**, i biri i Sokol, i datelindjes 09.07.1990, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim me nr.J00709056U;

**PALAPRANUESE E DHURIMIT:Z.Artid GJYLAMETI,** i biri i Ndreko, i datelindjes 28.10.1964, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim me nr. personal G41028030M.

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

## NENI 1– KUSHTE TË PËRGJITHSHME

1.1 Pala dhuruese, **Erik Hysenaj** eshte ortak i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar "**InFocus" sh.p.k** e cila është një person juridik shqiptar, e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, në Qendren Kombetare te Regjistrimit, me nr. NIPTI (NUIS) L62127029P dhe zotëron 100% te kuotave te kapitalit fillestar te shoqërisë me vlerë 1.000 (*nje mije* ) Lekë të cilat korrespondojnë 1 (*një*) pjese me vlere 1.000 (*nje mije)* Leke. Ky fakt vërtetohet dhe nga Ekstrakti i Regjistrit Tregtar te lëshuar nga QKR, për Shoqërinë **"InFocus"** Shpk, që i bashkelidhet kësaj kontrate.

**1.2** Me Vendimin e asamblesë së ortakëve te date 28.03.2018 te shoqërisë "**InFocus" sh.p.k** nder te tjera është vendosur:

a) Dhurimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë **"InFocus" sh.p.k** që zotërohen rregullisht në masën 100% te kuotave te kapitalit te shoqërisë me vlerë 1000 (*nje mije* ) Lekë, të cilat korrespondojnë 1 (*një*) pjese me vlere 1.000 (*nje mije)* Leke nga ortaku i vetem i shoqerise **Erik Hysenaj** perkatesisht 100 % te kuotave tek **Z.Artid GJYLAMETI.**



Artid Gjylameti

Elona SYLA
Notere

b) Shoqëria **"InFocus" sh.p.k**, behet shoqeri e ortakut te vetem i cili do te zoteroj ne kete shoqeri kuotat si me poshte:

- **Artid Gjylameti** zotërues i 100 (*njeqind)* % te kuotave në shoqerinë e mësipërme me vlerë 1000(*nje mije*) Lekë, të cilat korrespondojnë 1 (*nje*) pjese me vlere 1.000 (*nje mije*) Leke .

## NENI 2- OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë nëpermjet dhurimit të **100 %** të kuotave të kapitalit të shoqërisë **"InFocus" sh.p.k**, me vlerë 1000 (*nje mije)* Lekë, të cilat i korrespondojnë 1 (*nje)* pjese me vlere 1000 (*nje mije* ) Leke nga ortaku i vetem, ***Erik Hysenaj tek ortaku i ri Artid Gjylameti*** **,** sipas kritereve te përcaktuara ne ketë kontrate.

## NENI 3 – BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kesaj kontrate dhurimi neni 761 e vijues te Kodit Civil, Ligji 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", rregullimet e bera statutin të shoqërisë **"InFocus" sh.p.k** dhe në aktin e themelimit te kesaj te fundit.

## NENI 4- TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

**4.1** Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhuruesi ***Erik Hysenaj*** zhvishet nga pronesia e 100 % te kapitalit themeltar, te zoteruar ne shoqërinë **"InFocus" sh.p.k**, me vlerë 1000 (*nje mijë)* Lekë, të cilat korrespondojnë 1 (*nje)* pjese me vlere 1.000 (*nje mije)* Leke dhe pranuesi i dhurimit ***Artid Gjylameti*** behet pronar i vetem dhe zoteron 100 % te kapitalit te shoqerise **"InFocus" sh.p.k**, pasi e ka nenshkruar plotesisht kete kapital.

**4.2** Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash, shoqëria **"InFocus" sh.p.k** mbetet shoqeri me nje ortak, kapitali i se ciles eshte nenshkruar plotesisht dhe zoterohet si me poshte:

- **Artid Gjylameti** zotërues i 100 (*njeqind)* % te kuotave në shoqerinë e mësipërme me vlerë 1.000 (*nje mije*) Lekë, të cilat korrespondojnë 1 (*nje)* pjese me vlere 1.000 (*nje mijë*) Leke .

## NENI 5- TE NDRYSHME

**5.1** Kesaj kontrate i bashkelidhen dhe jane pjesë përbërese e saj dokumentacioni si me poshtë vijon:

i. Ektrakt I regjistrit tregtar i dates 28.03.2018.
ii. Vendimi i dates 28.03.2018 i Asamblesë së ortakut te vetëm te Shoqërisë **"InFocus" sh.p.k**;
iii. Kopje e dokumentacionit identifikues te palëve.



Artid Gjylameti

**5.2.** Kjo është një kontrate dhurimi kuotash e perpiluar ne kater kopje dhe pasi lexohet me ze te larte palëve pjesëmarrëse ne këtë akt ***Z.Erik Hysenaj*** dhe ***Z.Artid Gjylameti*** dhe pasi u gjendet ne përputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese dhe nënshkruhet rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit Une noterja, në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" *(i ndryshuar)*, deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj akt noterial/vertetim noterial në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALET KONTRAKTUESE**

| DHURUESI | PRANUESI I DHURIMIT |
| --- | --- |
| Erik HYSENAJ | Artid GJYLAMETI |

InFocus
CONSULTANCY

NOTERE
ELONA R. SYLA
NIPT: L 21913003 ...